QENDRA KOMBËTARE BURIMORE PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI

Gazetë Tremujore

Edicioni Nr. 11 Mars 2022

Kjo gazetë, është një publikim tremujor që pasqyron aktivitetet e Qendrës Kombëtare Burimore dhe zhvillimet më të fundit në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri, mundësitë për financim, rritje kapacitetesh e rrjetëzim për OShC-të si dhe informacione të tjera relevante nga rajoni e më gjerë.

NË KËTË EDICION

AKTIVITETET E QKB-SË

Programi i Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile për vitet 2022-2025

Shërbim ligjor për organizatat e shoqërisë civile

Thirrje për aplikime në programin e trajnimit dhe mentorimit "Gjenerimi i të ardhurave për OSHC-të nga shërbimet me pagesë, produktet dhe asetet"

Mbi Vullnetarizmin dhe zhvillimin e tij në Shqipëri

Aktivitete nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Standards4NPOs - Mekanizmi online i vetëvlerësimit për OSHC-të në Shqipëri

Kodi i Standardeve për OShC-të

Akademia e OJF-ve

Asistencë dhe mentorim për pjesëmarrësit e Akademisë

ZHVILLIMET E FUNDIT NË SEKTOR

Aktiviteti publik "Zëri ynë ka Rëndësi"

Rimbursimi i TVSH-së për OJF-të, më në fund bëhet funksional në Shqipëri

Thirrje për organizatat e shoqërisë civile për të mbështetur popullsinë ukrainase të goditur nga lufta

Deklarate Publike nga OSHC-të mbi oponencën e tyre ndaj Propozimeve për Hartën e Re Gjyqësore për Shqipërinë

Takim i OJF-ve me Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mbi ofrimin e shërbimeve PAK

Takimi i Parlamentit të Shqipërisë me OSHC-të dhe median mbi qasjen në bashkëhartimin e standardeve të transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut

Ndërtimi i partneriteteve ndërsektorale OSHC - Sektor privat

Forume Rajonale mbi Ndikimin e Covid-19 në Ballkanin Perëndimor

Event global online mbi "Avancimin e Llogaridhënies Parlamentare në Kontekstin e Krizave"

Publikohet raporti "Udhëzuesi për Shoqërinë Civile 2020 - Raport Vlerësimi"

THIRRJE DHE MUNDËSI

Thirrje

Njoftime

Programi i Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile për vitet 2022-2025



Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, bazuar në nevojat e sektorit do të vijojë shërbimet me një program të pasur dhe të larmishëm. Për më shumë informacion gjeni këtu një përshkrim të plotë të programit dhe na kontaktoni për t'u bërë pjesë e tij, sipas interesit dhe nevojave tuaja.

Shërbim ligjor për organizatat e shoqërisë civile

Shërbimi Ligjor për OJF-të dhe aktivistët e shoqërisë civile, është një ndër shërbimet më të fundit që i është shtuar gamës së shërbimeve help-desk që Qendra ofron për sektorin.

Ky shërbim përfshin ofrim informacioni dhe edukim ligjor për OJF-të si dhe këshillim ligjor në lidhje me krijimin, funksionimin, përputhshmërinë ligjore dhe fiskale, dhe çregjistrimin ligjor të organizatave.

Për më shumë informacion mbi shërbimin ligjor dhe si të përfitoni prej tij, lexoni këtu.

Gjatë këtyre muajve, disa organizata janë asistuar kryesisht mbi çështje si regjistrimi dhe marrja e statusit të sipërmarrjes sociale, hapja dhe regjistrimi I degëve të dyta të organizatës, procedura e rimbursimit të TVSH-së, procedura e regjistrimit të pronarëve përfitues si dhe deklarimet pranë tatimeve. Po ashtu disa aktivistë dhe grupime informale janë këshilluar lidhur me themelimin e organizatave të reja dhe regjistrimin formal të tyre në Gjykatë.



Thirrje për aplikime në programin e trajnimit dhe mentorimit "Gjenerimi i të ardhurave për OSHC-të nga shërbimet me pagesë, produktet dhe asetet"

Kujtojmë të gjitha organizatat e interesuara që thirrja është e hapur. Mirëpresim aplikimet tuaj. Afati i fundit për aplikim është data 4 maj, 2022! Për më shumë rreth aplikimit, njihuni këtu

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB), është një iniciativë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA). Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Advokim dhe Dialog për Politikëbërje

Mbi Vullnetarizmin dhe zhvillimin e tij në Shqipëri

Më datë 21 shkurt, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë I Kuvendit të Shqipërisë, organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësues të qeverisë mbi ligjin "Për Vullnetarizmin". Organizatat e shoqërisë civile u informuan mbi këtë seancë dëgjimore dhe rendin e ditës për diskutim vetëm nga faqja e internetit të Kuvendit të Shqipërisë.

Diskutimi gjatë seancës u fokusua kryesisht në Nenin 22 të Ligjit "Për vullnetarizmin" duke anashkaluar një seri problematikash të tjera që Ligji ka. Megjithëse kanë kaluar 6 vjet nga miratimi i ligjit, kuptimi dhe zbatimi i tij si nga ana e organizatave të shoqërisë civile, po ashtu dhe e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij mbetet problematik.

Në kohën e propozimit dhe miratimit të tij, Ligji nuk u konsultua me grupet e interesit dhe as u mor parasysh zhvillimi i vullnetarizmit në vend. Propozimi nuk ishte mjaftueshëm i bazuar në evidenca dhe i studiuar, duke bërë që edhe pas 6 vitesh të jemi në situatën e pazbatueshmërisë së tij.

Me iniciativë të Organizatës Përtej Barrierave në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile dhe mjaft organizata të tjera në vend, prej më shumë se 2 vitesh është diskutuar në një seri tryezash mes sektorit dhe institucioneve për problematikën e ligjit dhe është kërkuar ngritja e një grupi pune për rishikimin e tij.

Pas seancës dëgjimore, Përtej Barrierave dhe Qendra Burimore, në emër të Grupimit për Vullnetarizmin, ju drejtua sërish institucioneve përgjegjëse me këtë kërkesë. Më datë 29 mars, një takim online u organizua me Ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, zv. ministren e Financave dhe të Ekonomisë, Olta Manjani, drejtorin e Përgjithshëm të AKPA-s, Klevis Hysa, stafin e MFE-së dhe kolegë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, ku diskutuam mbi problematikën e ligjit dhe ngritjen e një grupi pune të përbashkët për rishikimin e ligjit.

Për tu njohur më shumë me përpjekjet dhe punën grupit për vullnetarizmin gjeni këtu Letra e Hapur dhe Opinioni Ligjor mbi këtë çështje.





Aktivitete nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Gjatë takimit me OSHC-të e Vlorës për të diskutuar mbi situatën e refugjatëve të krijuar nga lufta në Ukrainë dhe koordinim më të mirë nga strukturat vendore shtetërore në rast të rritjes së numrit të refugjatëve në vendin tonë. - ***Zyra Rajonale Vlorë***

Gjatë takimit me një grup këshilltarësh të Këshillit Bashkiak Vlorë për të advokuar mbi adresimin e çështjes së transportit publik për zonat rurale përmes peticionit të dorëzuar tashmë. - ***Zyra Rajonale Vlorë***

Nga takimi me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile IPA Scodrinon për identifikimin e partnerëve në shkrimin e projekt propozimeve. - ***Zyra Rajonale Shkodër***

Qendra ka zhvilluar disa takime me OJF-të lokale, duke i informuar mbi mundësi financimi dhe thirrje për projekt propozime të donatorëve të ndryshëm - ***Zyra Rajonale Shkodër***

Nga tryeza e rrumbullakët me disa OSHC të Shkodrës në përgjigje të situatës së luftës në Ukrainë dhe solidaritetit për refugjatët. - ***Zyra Rajonale Shkodër***

Standards4NPOs - Mekanizmi online i vetëvlerësimit për OSHC-të në Shqipëri

Vetëvlerësimi online Standards4NPOs është krijuar për të ndihmuar OSHC-të të vlerësojnë në mënyrë cilësore (sugjerime automatike me shkrim) dhe sasiore (sistem vlerësimi i pikëzuar) standardet e tyre të qeverisjes; procedurat administrative dhe financiare; politikat e burimeve njerëzore (punësimi/ shkarkimi/promovimi); llogaridhënien ndaj përfituesve/anëtarëve; financimin, mbledhjen e fondeve dhe menaxhimin e burimeve; advokimin e përgjegjshëm dhe ndërtimin e partneritetit, si dhe shumë aspekte të tjera.

Mekanizmi vetëvlerësues synon të udhëheqë mënyrën se si organizatat funksionojnë dhe ndërmarrin veprime për përmirësimin e rezultateve të veprimtarisë së tyre në një mënyrë strategjike dhe të planifikuar. Për të gjitha OSHC-të që dëshirojnë të rrisin dhe përmirësojnë standardet e tyre të punës, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri tashmë ka prezantuar dhe po zbaton programin e saj për ngritjen e kapaciteteve, me një qasje të përshtatur sipas fazave të ndryshme të zhvillimit institucional të OSHC-ve.

Mekanizmi Vetëvlerësues gjendet në platformën web si dhe aplikacion mobile për IOS dhe Android.

Për çdo pyetje lidhur me procesin e vetëvlerësimit, kontaktoni Qendrën Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri në +355 4 2254881, ose info@resourcecentre.al

Kodi i Standardeve për OJF-të në Shqipëri

Edhe në këto tre muaj, Qendra Burimore, në cilësinë për Sekretariatit të Kodit të Standardeve për OJF-të, ka vijuar promovimin e Kodit të Standardeve të OJF-ve si një mekanizëm që u shërben organizatave për rritjen e standardeve të veprimtarisë së tyre dhe qendrushmërisë. Në të njëjtën kohë, është ofruar informacion dhe asistencë për të gjitha organizatat e interesuara për t`u anëtarësuar në Kod.

Gjatë kësaj periudhe 13 organizata kanë shprehur interesin t`i bashkohen anëtarësisë së Kodit të Standardeve dhe janë në proces anëtarësimi.

Ju rikujtojmë se shprehja e interesit për anëtarësim është i hapur në çdo kohë për çdo OJF të interesuar. Për më shumë rreth mënyrës sesi mund të anëtarësoheni klikoni këtu

Akademia e OJF-ve 2022

Prej muajit janar ka rifilluar programi i Akademisë së OJF-ve për vitin 2022. Akademia është një program vjetor që u jep mundësinë drejtuesve të OSHC-ve dhe manaxherëve të nivelit të lartë të rrisin aftësitë dhe të zhvillojnë kompetenca. Pas një thirrje të hapur për shprehje interesi, 24 përfaqësues të OSHC-ve u zgjodhën për të marrë pjesë në Akademinë e këtij viti.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar dy leksionet e para respektivisht mbi "Kuadri Ligjor për OJF-të në Shqipëri" dhe "Procesi i integrimit të Shqipërisë në BE dhe roli i OSHC-ve". Akademia e OJF-ve është një nga aktivitetet kryesore të Qendrës Kombëtare Burimore për ngritjen e kapaciteteve të sektorit.

Programi tashmë në vitin e 8-të të zbatimit të tij, është konsoliduar dhe vlerësohet nga OJF-të si një ndër programet kryesore që mbështet formimin e drejtuesve dhe stafit të organizatave. Për më shumë informacion, gjeni këtu programin.

#Leksioni1

Kuadri Ligjor për OJF-të në Shqipëri

#Leksioni2

Procesi i integrimit të Shqipërisë në BE dhe roli i OSHC-ve

AKTIVITETET E QKB

Asistencë dhe mentorim për pjesëmarrësit e Akademisë

Paralelisht me zhvillimin e leksioneve, janë zhvilluar dhe seancat e para të mentorimit me akademistët. Procedura e regjistrimit të pronarëve përfitues, fiskalizmi dhe deklarimet e OJF-ve pranë organeve tatimove, aplikimi për rimbursimin e TVSH-së, aplikimi për regjistrimin dhe marrjen e statusit të sipërmarrjes sociale si dhe procedura e pjesëmarrjes në grupet ndërsektoriale në procesin e konsultimeve në kuadër të Integrimit Europian ishin disa nga çështjet e trajtuara përgjatë seancave.

Aktiviteti publik "Zëri ynë ka Rëndësi"

Në datë 29 mars, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim organizuan aktivitetin "Zëri ynë ka Rëndësi" me pjesëmarrjen e dhjetra organizatave të shoqërisë civile dhe të rinjve aktivistë.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me disa nisma të suksesshme të të rinjve në dobi të komunitetit si dhe me praktika të sukseshme të organizatave të shoqërisë civile lidhur me përmirësimin e standardeve të qeverisjes dhe veprimtarisë organizative në përputhje me Kodin e Standardeve për OJF-të në Shqipëri, si dhe diversifikimin e burimeve të financimit për më shumë qendrueshmëri financiare të sektorit jofitimprurës në vend. Lexoni më shumë mbi takimin

Rimbursimi i TVSH-së për OJF-të, më në fund bëhet funksional në Shqipëri

Pas disa vitesh përpjekje të sektorit dhe punës me institucionet, shihen rezultatet e para pozitive për rimbursimin e TVSH për sektorin jo-fitimprurës në vend. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është bërë rimbursimi për 4 projekte të zbatuara nga OJF-të në vend për vitin 2021. Rikujtojmë të gjitha organizatat e interesuara se procedura e rimbursimit të TVSH-së për grantet e donatorëve të huaj kryhet bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 34, datë 5.12.2019 https://bit.ly/3GBj9Ay, mbi procedurën e rimbursimit të TVSH. Për më shumë mbi kuadrin ligjor dhe rregullator rreth detyrimeve tatimore për OJF-të, por dhe të tjera, ju ftojmë të konsultoheni me rubrikën Pyetje-Përgjigje https://resourcecentre.al/sq/pyetje-te-shpeshta/ në Website tonë ose na shkruani në info@resourcecentre.al për këshillim apo asistencë.

Thirrje për organizatat e shoqërisë civile për të mbështetur popullsinë ukrainase të goditur nga lufta

Përmes një thirrje publike në datën 2 shkurt, një grup prej 19 organizatash të shoqërisë civile që kanë si mision mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dënuan ashpër sulmin brutal ushtarak Rus ndaj Republikës së pavarur të Ukrainës.

Lexo thirrjen e plotë



Deklarate Publike nga OSHC-të mbi oponencën e tyre ndaj Propozimeve për Hartën e Re Gjyqësore për Shqipërinë

Me iniciativën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, një grup prej 9 organizatash të shoqërisë civile, përmes një Deklarate publike, vlerëson në parim, si një proces shumë të rëndësishëm, riorganizimin e gjykatave dhe kompetencave të tyre tokësore. Ky proces i njohur ndryshe si, harta gjyqësore, vlerësojnë se mbart një rëndësi kyç për rritjen e aksesit, cilësisë dhe reduktimin e kostove për qytetarët në marrjen e drejtësisë dhe në respektim të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor. Lexoni deklaratën e plotë këtu



Takim i OJF-ve me Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mbi ofrimin e shërbimeve PAK

Në datën 02 shkurt, në mjediset e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime dhe mbrojnë të drejtat e personave me aftësi ndryshe zhvilluan një takim me Ministren Znj. Ogerta Manastirliu, zv.ministren Znj. Denada Seferi për të forcuar bashkëpunimin për zgjerimin e shërbimeve në vend.

Hartimi i standardeve kombëtare të ndërhyrjes së hershme për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në zhvillim, hartëzimi i shërbimeve të ndërhyrjes së hershme dhe atyre të specializuara për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara në rang kombëtar, referimi në shërbime të specializuara, bazuar në nevoja, nga ana e komisioneve të vlerësimit multidisiplinor për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale, realizimi i kostimit të shërbimeve si një mjet rregullator i shërbimeve publike dhe private për personat me aftësi të kufizuara, reduktimi i tarifës së energjisë elektrike për ofruesit e shërbimeve për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, me vlerë më të ulët se ajo e biznesit dhe mbështetja e ofruesve të shërbimeve duke siguruar 30%-50% të buxhetit të tyre vjetor ishin disa nga çështjet kryesore të diskutuara gjatë takimit. Lexo më shumë

Takimi i Parlamentit të Shqipërisë me OSHC-të dhe median mbi qasjen në bashkëhartimin e standardeve të transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut

Parlamenti I Shqipërisë, në 1 mars zhvilloi takimin e parë për të diskutuar mbi qasjen në bashkëhartimin e standardeve të transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut.

Në takim morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile dhe medias, të cilët përshëndetën nismën e Kuvendit dhe shprehën gatishmërinë për të qënë pjesë e grupit të punës së hartimit të këtyre standardeve.

Ndërtimi i partneriteteve ndërsektorale OSHC - Sektor privat



Më 3 mars, BCSDN organizoi eventin rajonal online "Aleanca e pazakontë për të mirën e përbashkët: Bashkëpunimi OSHC – Sektor Privat". Si pjesë e takimit organizatat nga vendet e rajonit prezantuan praktikat e mira dhe shembuj të suksesshëm të bashkëpunimit me sektorin privat të sipërmarrësve socialë me një objektiv të përbashkët për të sjellë një ndryshim pozitiv ose për të promovuar hapësirën qytetare.

Partnerët Shqipëri me një eksperiencë të gjatë tashmë në këtë drejtim dhe një sërë programesh që mbështesin bashkëpunimin mes OSHC-ve dhe sektorit privat, prezantoi praktikën në Shqipëri dhe disa arritje konkrete në mbështetje të sektorit.

Forume Rajonale mbi Ndikimin e Covid-19 në Ballkanin Perëndimor

Prej disa muajsh, ka nisur zbatimi I një iniciative të përbashkët rajonale mes Qendrave Kombëtare Burimore të Shoqërisë Civile në vendet e rajonit, mbi "Nxitja e bashkëpunimit rajonal dhe politikave në kohë krize". Iniciativa synon të identifikojë impaktin social-ekonomik të Covid-19 në Ballkan nga këndvështrimi i të gjitha palëve të interesuara, duke kontribuar në shkëmbimin e përvojës dhe sfidave si dhe promovuar praktikat e suksesshme të përshtatshmërisë në përgjigje të Covid-19. Nisma është ndërmarrë nga Partnerët Shqipëri dhe zbatohet në partneritet me 5 organizatat që manaxhojnë Qendrat Burimore në Bosnje e Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Kosovë dhe Serbi. Si pjesë e nismës përgjatë muajve shkurt-mars u zhvilluan dy forume rajonale tematike, me përfaqësues të OSHC-ve, rrjeteve rajonale, organizata ndërkombëtare, akademikë, përfaqësues nga sektori privat, media, institucione shtetërore dhe palë të tjera të interesuara nga i gjithë Ballkani.

Forumi "**Ndikimi i COVID-19 në ekonomi, me fokus të veçantë në ekonominë sociale",** organizuar më 28 shkurt 2022 nga Macedonian Center for International Cooperation (MCIC), u fokusua nw diskutime mbi ndikimin e COVID-19 në ekonomi, veçanërisht në ekonominë sociale, duke theksuar çështjet dhe sfidat kryesore me të cilat përballën dhe masat që janë ndërmarrë, si dhe krijimin e sinergjisë për reagim të koordinuar në rajon në të ardhmen në rast krize. Lexo më shumë mbi forumin.

Gjatë forumit rajonal "Ndikimi i COVID-19 në ekonomi, me fokus të veçantë në ekonominë sociale "

Forumi **"Reagimi dhe përshtatja e organizatave të shoqërisë civile ndaj situatës COVID-19"** organizuar më 29 mars 2022, nga Qendra për Zhvillimin e OJQ-ve (CRNVO), në Mal të Zi, u fokusua në ndikimin e COVID-19 tek OShC-të; komunikimi dhe bashkëpunimi i OSHC-ve me Qeverinë në përgjigje të krizës së COVID-19 dhe shembuj të kontributit të OSHC-ve në përgjigje të COVID-19. Lexo më shumë mbi forumin







Gjatë forumit rajonal "Reagimi dhe përshtatja e organizatave të shoqërisë civile ndaj situatës COVID 19"

Në vijim, katër forume të tjera do të organizohen përgjatë muajve të ardhshëm, Për më shumë referohuni kalendarit të Qendrës ose na shkruani në info@resourcecentre.al

Event global online mbi "Avancimin e Llogaridhënies Parlamentare në Kontekstin e Krizave"



Më datë 24 shkurt 2022 Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI) organizuan një event global online mbi "Avancimin e Llogaridhënies Parlamentare në Kontekstin e Krizave". Takimi mundësoi shkëmbimin e praktikave të mira në llogaridhënien parlamentare si nga përvojat e deputetëve ashtu dhe të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile në nivel global.

Si një ndër kontribueset në panelet e diskutimit, Ariola Agolli, Manaxhere e Qendrës Burimore për Shoqërinë Civile në Partnerët Shqipëri, ndau përvojat në bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, aksesin në informacion dhe konsultime me shoqërinë civile dhe qytetarët si dhe disa rekomandime nisur nga konteksti lokal dhe rajonal në vendet e Ballkanit Perëndimor, për përmirësimin e llogaridhënies parlamentare. Për më shumë lexoni këtu

Publikohet raporti "Udhëzuesi për Shoqërinë Civile 2020 - Raport Vlerësimi"

Në prill, EU TACSO ka publikuar raportin "Udhëzuesi për Shoqërinë Civile 2020 - Raport Vlerësimi"

Raporti ofron një analizë të situatës për vitin 2020, në një kohë krize në të gjithë rajonin. Ai ofron njohuri mbi sfidat dhe sukseset e OSHC-ve në përgjigjen ndaj pandemisë Covid-19 dhe tendencat e mjedisit mundësues për shoqërinë civile. Lexoni raportin e plotë

hapur

hapur

hapur

#RrathëDhurues Shqipëri

hapur

hapur



hapur

mbyllur

U.S. EMBASSY Tirana, Albania

hapur

mbyllur

mbyllur

mbyllur

mbyllur

mbyllur

THIRRJE DHE MUNDËSI

QENDRA KOMBËTARE BURIMORE PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI

KALENDAR TREMUJOR

Shënoni në kalendarin tuaj! Përfshihu në aktivitetet tona të ardhshme!

Prill 2021

S	M	T	Ë	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

Maj 2021

S	M	T	Ë	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

Qershor 2021

S	M	T	Ë	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

Akademia e OJF-ve

Trajnime dhe Seminare për OShC-të

Aktivitete rrjetëzimi

Forume Publike dhe Evente

NA KONTAKTONI :

Zyra në Tiranë

Rruga e Elbasanit, PARK GATE, Kati i 10të, Ap. 73, Tiranë

(në mjediset e "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim")
Tel/Fax: +355 4 2254881

E-mail: info@resourcecentre.al

Zyra në Shkodër

Lagjja Kongresi i Përmetit, Rr. Oso Kuka, Kati i 2të, Hyrja 1, Shkoder
(në mjediset e Shoqatës "Gruaja në Zhvillim")

E-mail: shkodra@resourcecenter.al

Zyra në Vlorë

Lagjja 29 Nëntori, Rr. Dede Ahmet Amataj, Çerdhja 15, Kati i 2të, Vlorë

(në mjediset e Qendrës "Aulona")
Tel: +355 3 3224531

E-mail: vlora@resourcecenter.al

NA NDIQNI : @resourcecentre.al @resourcecentrealbania @resourceCSO_al @ResourceCentreAlbania

@http://ëëë.resourcecentre.al/